



**KONTROLLI I LARTË I SHETITR**  
**Raport Përfundimtar Auditimi Tematik ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve**

## **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“AUDITIM TEMATIK PËRPUTHSHMËRIE”**

**NË**

**MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTEVE**

**Janar 2023**

**I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

- 1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....
- 2.Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve.....
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....

**II. HYRJA**

- 1.Objekti i auditimit.....
- 2.Qëllimi i auditimit.....
3. Identifikimi i çështjes.....
- 4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....
- 5.Përgjegjësitë e audituesve.....
- 6.Kriteret e vlerësimit.....
- 7.Standardet e auditimit.....
8. Metodatat e auditimit.....
- 9.Dokumentimi auditimit.....

**III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:
  - 2.1. Mbi dhënien e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen s sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë.....
  - 2.2 Çështje të ndryshme të dala gjatë auditimit.....

**IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....****V. ANEKSE.....**

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

### I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Raporti i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve (*këtu e më poshtë MAS*), prezanton çështje specifike të rezultuara në përputhshmërinë e procedurës së dhënies së shpërblimeve sportistëve elitare me kuadrin ligjor dhe rregullator në lidhje me: kriteret e mënyrat e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre. Disa nga gjetjet kryesore të evidentuara, si dhe rekomandimet përkatëse në mënyrë të përmbledhur jepen më poshtë.

### I.2 Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi.

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. NË RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	<p>Nga auditimi mbi shpërblimin e sportistëve elitare për periudhën 01.01.2021 deri me 30.06.2022 rezultoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-rregullorja e brendshme nuk është e përditësuar me përshkrimet e proceseve të punës për drejtoritë përkatëse në aspektin e përgjithshëm dhe atë specifik,</li><li>-mungon një bazë të dhënash/data bazë tip e miratuar, e cila të japë informacion të analitik për procedurën e shpërblimit të sportistëve elitare, me qëllim transparencën dhe auditimin e tyre;</li><li>-Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar nuk parashikon afate ligjore në të cilën kalon procedura e shpërblimit të sportistëve elitare, duke filluar nga shpallja e rezultateve zyrtare, përgjigja zyrtare për testet antidoping nga organizmat përkatës njohura me ligj deri në finalizimin për dhënie e shpërblimit, si dhe mosparashikimi i të drejtën së ankimit dhe organit që e shqyrton, në rastet kur kërkesa për shpërblim nuk pranohet, nuk merret në shqyrtim apo refuzohet.</li></ul>	Fq. 6-15	I mesëm	<p>1.1 Të merren masa nga titullari i institucionit/MAS, për përditësimin e rregullores së brendshme të funksionimit me ndryshimet e reja strukturore duke përcaktuar qartë përshkrimin e proceseve të punës për drejtoritë përkatëse, specifikisht ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës për shqyrtimin dhe vlerësimin e shpërblimit për sportistët elitare ku në përbërje të jetë specialisti i fushës, si dhe miratimin si pjesë integrale të rregullores së data bazës së të dhënave për shpërblimin e sportistëve elitare.</p> <p>1.2 Të merren masa nga MAS-i për propozimin për përmirësimin e legjislacionit për sportin duke bërë shtesat e nevojshme në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, duke vendosur afate ligjore nëpër të cilën kalon procedura e shpërblimit të sportistëve elitare, që nga shpallja e rezultateve zyrtare, përgjigja zyrtare për testet antidoping nga organizmat përkatës njohura me ligj deri në finalizimin për dhënie e shpërblimit, si dhe parashikimin e të drejtës së ankimit dhe organit që e shqyrton, në rastet kur kërkesa për shpërblim nuk pranohet, nuk merret në shqyrtim apo refuzohet.</p>
2	<p>Nga auditimi i praktikave dhe konkretisht i praktikës së shpërblimit të sportistit M.M</p>	Fq. 6-15	I mesëm	2.1 Të merren masa nga MAS për propozimin për përmirësim

	<p>rezultoi se:</p> <p>-Shkresa nr.46 prot., datë 30.03.2022 e Federatës nuk figuron e administruar në protokollin e MAS-it për pasojë nuk është kthyer përgjigje kësaj kërkesë;</p> <p>-nuk është bërë verifikimi apo dhe të jetë shprehur në arsyetimin e kthimit të përgjigjes (me shkresën nr. 5639/1 prot., datë 13.10.2022) se event i kampionati “IFBB DIAMOND CUP PORTUGAL &amp; IFBB ELITE PRO WORLD CHAMPIONSHIPS” (ku në kuptimin e përgjithshëm përfshihet në termin “kampionat botëror”) për të cilin kërkohet shpërblimi, referuar rregulloreve ndërkombëtare të këtyre veprimtarive, nuk figuron të jetë i përfshirë si event për të cilin ligji dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021 nuk parashikon shpërblim.</p>			<p>ligjor të legjislacionit për sportet duke kërkuar shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, konkretisht të nenit 27, pika 1, germa “c”, me qëllim përcaktimin e saktë të të gjithë eventeve të listuara për të cilat ligji njeh të drejtën e shpërblimit</p>
3	<p>Nga verifikimi i bërë në ZVAP Librazhd në përgjigje të ankesës së ardhur në KLSH si dhe në MAS mbi rimbursimin e plotë të çmimit të biletës së transportit të mësuesve që udhëtojnë në linjën Librazhd-Gorenjë dhe anasjelltas, rezultoi se: Referuar Aneksit1 “Tabela e kilometrave dhe çmimi i biletave për linjat rrethqytetase të Bashkisë Librazhd “(sektori i taksave) miratuar nga Bashkia Librazhd, distanca Librazhd-Orenjë në km është përcaktuar 24, ndërsa çmimi i biletës në lek është përcaktuar 200 lekë, ndërkohë që në VKM Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime në Aneksin 1, Pasqyra 1, “Çmimet e bileta vetë transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” ka përcaktuar distancat dhe çmimet referuese. Akti i për çmimin e biletave dhe distancat i shprehur në km i nxjerrë nga Bashkia Librazhd dhe Aneksi 1, Pasqyra 1 VKM Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime janë akte të pa unifikuara dhe sjellin si pasojë, referime të ndryshme çmimi për distanca të njëjta duke krijuar standarde të ndryshme për çmimin e biletës.</p>	Fq. 15-18	I mesëm	<p>3.1 Të merren masa nga titullari i MAS-it që të propozojë përmirësime ligjore në VKM Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime, Aneksi 1, Pasqyra 1, “Çmimet e biletave të transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” duke bashkëpunuar në këtë drejtim me organet e vetëqeverisjes vendore për unifikimin e distancave në km, shprehur për qytet dhe fshat të RSH si dhe çmimit të miratuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas distancave, me qëllim që Aneksi 1, Pasqyra 1, të jetë gjithëpërfshirës në hartën e transportit ndërqytetas për arsimtarët.</p>
4	<p>Nga auditimi i praktikave dhe konkretisht i praktikës së shpërblimit të sportistit M.M rezultoi se:</p> <p>-Shkresa nr.46 prot., datë 30.03.2022 e Federatës nuk figuron e administruar në protokollin e MAS-it për pasojë nuk është kthyer përgjigje kësaj kërkesë;</p> <p>-nuk është bërë verifikimi apo dhe të jetë shprehur në arsyetimin e kthimit të përgjigjes (me shkresën nr. 5639/1 prot., datë 13.10.2022) se event i kampionati “IFBB DIAMOND CUP PORTUGAL &amp; IFBB ELITE PRO WORLD CHAMPIONSHIPS” për të cilin kërkohet shpërblimi, referuar rregulloreve ndërkombëtare të këtyre veprimtarive, nuk figuron të jetë i përfshirë si event për të cilin ligji dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021 nuk parashikon shpërblim.</p>	Fq. 6-15	I mesëm	<p>4.1 Të merren masa nga MAS për shqyrtimin e kërkesës së Federatës nr.46 prot., datë 30.03.2022 për shpërblimin e sportistit M.M në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar.</p>

### I.3 Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve (MAS), kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së këtij subjekti me ligjet dhe aktet normative, mbi shpërblimin dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë në zbatim të Ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, si dhe çështje të dala nga auditimi që kanë të bëjnë me shpenzimet e biletës për transportin e mësuesve në Librazhd (Orenjë) në zbatim të VKM Nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” si dhe verifikimin e procedurës së ndjekur nga shkolla e mesme “Thoma Papajano” Gjirokastër mbi vlerësimin e kualifikimit për vend të lirë pune për periudhën nga 01.01.2021 deri më 30.06.2022.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e MAS-it, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinion”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni **të kualifikuar (modifikuar)/i cilësuar**<sup>1</sup>.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese. Besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë, janë të mjaftueshme dhe përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Konkluzionet dhe opinionin ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga MAS, e cila konsiderohet nga ana e jonë e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin profesional dhe kemi ushtruar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme.

Procedura e auditimit është bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë; praktikat e mira që lidhen me pavarësinë dhe ISSAI 130, Kodin e Etikës së INTOSAI dhe Kodin e Etikës së KLSH-së, si dhe dokumentimi i auditimit ka shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

#### **Baza për opinion të kualifikuar (modifikuar)/i cilësuar.**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH”, pjesë e Raportit. Ne jemi të pavarur nga subjekti kundrejt subjektit të audituar e theksuar kjo në INTOSSAI P-10 Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe INTOSAI P 30-Kodi Etik apo dhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare, të cilat përmenden në ISSAI 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu dhe Kodin e Etikës së KLSH-së miratuar me Vendimin Nr.27, datë 20.04.2018 të Kryetarit të KLSH. Gjithashtu ne

---

<sup>1</sup> Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, (Qershor 2020, fq.104), Kapitulli VII, pika 7.3.3 “Angazhimet e Vërtetimit me Siguri të Arsyeshme”, Konkluzionet/ Opinonet e pakualifikuara: *Opinion i kualifikuar/i cilësuar*, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.

besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës tonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar të auditimit.

Rastet e mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara përgjithësisht janë si më poshtë:

-Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për shpërblimin dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë për periudhën 01.01.2021 deri 30.06.2022, rezulton se:

-Rregullorja e brendshme e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk është e përditësuar me ndryshimet që ka pësuar struktura organike miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.144, datë 16.12.2021 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë*";

-Në grupin e punës për trajtimin e shpërblimeve për sportistët elitari mungon specialisti i fushës (*llojit të sportit për të cilin aplikohet për shpërblim*);

-Mungon baza e të dhënave/data bazë tip e miratuar, ku të jepen dhe përditësohen të dhëna mbi shpërblimin e sportistëve elitari;

-Praktikat e aplikimit për dhënie shpërblimi për sportistët elitari, nuk janë të administruara në dosje të inventarizuara me dokumentacionin përbërës dhe të protokolluar sipas legjislacionit "Për arkivat".

-Ligji Nr. 79/2017 "*Për sportin*" i ndryshuar dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021, nuk parashikon afat ligjor për ndjekjen e procedurës për shpërblim të sportistëve elitari si dhe nuk parashikon të drejtën e ankimit dhe organin që e shqyrton, në rastet kur kërkesa për shpërblim nuk pranohet, nuk merret në shqyrtim apo refuzohet.

-Ligji Nr. 79/2017 "*Për sportin*" i ndryshuar, neni 27, pika 1, germa "c", si dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021, në kuptimin literal, nuk përcakton qartë konkretisht cilat janë veprimtaritë ndërkombëtare të parashikuara në pikën 1, germa "a" dhe "b", në rastet e sporteve individuale për të cilat si rregullimin ligjor të tyre, duhet referuar rregulloret ndërkombëtare të këtyre veprimtarive.

-Nga auditimi i praktikës së ndjekur për shpërblimin e sportistit M.M sipas kërkesës së Federatës Shqiptare të bodybuilding & fitnes dhe trajnerit të tij, rezultoi se refuzimi i kërkesës nga ana e MAS-it është jo në përputhje me kriteret e Ligjit Nr. 79/2017 "*Për sportin*" i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, neni 27, pika 1, germa "c", VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13 dhe Urdhri i ministrit të Arsimit dhe Sporteve Nr.352, datë 17.06.2019 "*Për miratimin e rregullores së brendshme së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë*" Kreu IV, neni 21, pika 2;

-në 4 raste praktikat për dhënien e shpërblimit sportistëve elitari, kanë mungesë dokumentacioni.

### **Përgjegjësitë e drejtuesve të Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit.**

Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si: Ligji Nr. 79/2017 "*Për sportin*" i ndryshuar, VKM Nr. 682, datë 29.07.2015 e ndryshuar "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:**

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme dhe dhënien e opinionit nëse aktiviteti i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve është kryer në përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi specifikisht për shpërblimin e sportistëve elitari. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse

individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar.

Përveç standardeve ISSAI, ne gjithashtu kemi aplikuar gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

## II HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.895/1, datë 14.10.2022 i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 14.10.2022 deri në datë 30.11.2022, në subjektin Ministria e Arsimit dhe Sporteve (*këtu e më poshtë MAS*), u krye auditimi “Auditim tematik përputhshmërie” për periudhën nga 01.01.2021 deri në 30.06.2022 nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.M.H, (Përgjegjës Grupi)
- 2.E.K, Auditues

Auditimi u shtri specifikisht mbi procedurën e ndjekur për dhënien e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë si dhe çështje që u evidentuan gjatë auditimit mbi ankimet e adresuara në KLSH si: rimbursimin e çmimit të biletës së transportit të mësuesve që udhëtojnë në linjën Librazhd-Gorenjë dhe anasjelltas si dhe për verifikimin e procedurës së ndjekur për mësuesit që kanë aplikuar për vende pune në SHMP “Thoma Papajano” Gjirokastër”.

Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit u mbajtën aktkonstatim dhe aktverifikim si dhe u organizua takimi përmbyllës në terren (MAS) me datë 30.11.2022 me përfaqësues të strukturave drejtuese (*Sekretari i Përgjithshëm z.E.T dhe Drejtori i Drejtoria e Politikave të Sportit z. J.G.J*) që kanë në kompetencë çështjet e trajtuara, në aktet e mbajtura, si dhe grupit të auditimit. Takimi përmbyllës në terren u mbajt sipas protokollit përkatës (*Dokumenti standard 13*) parashikuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit, miratuar me Vendimin nr.107 datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH e ndryshuar.

### 1. Objekti i auditimit.

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit, përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator duke përfshirë këtu, dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së tij, nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti i veprimtarisë është në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

### 2. Qëllimi i auditimit.

Auditimi synon në vlerësimin, nëse procedurat dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi në sektorin publik, Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar si dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021”*Për kriteret e mënyrat e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre*”.

Auditimi synon në përcaktimin nga ana e audituesve:

- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme për shpërblimin e sportistëve elitare/të nivelit të lartë;
- dhënien e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

### **3. Identifikimi i çështjes.**

Raporti përfundimtar mbi auditimin tematik të përputhshmërisë në MAS, për periudhën 01.01.2021 deri më 30.06.2022, ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

-Vlerësimin e procedurës së ndjekur nga MAS mbi shpërblimin e sportistëve elitari/ të nivelit të lartë, në përputhje me Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar si dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021”Për kriteret e mënyrat e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre”.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.**

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Ato janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet dhe afatet vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë/MAS-it dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-<sup>së</sup>) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme për shpërblimin e sportistëve elitari/ të nivelit të lartë.

### **6. Kriteret e vlerësimit.**

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:

-Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

-Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar ;

-VKM Nr.789, datë 15.12.2021”Për kriteret e mënyrat e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre”.

### **7. Standardet e auditimit.**

Standardet e zbatuara nga grupi gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

-ISSAI 100 (Parime parimet themelore të auditimit të sektorit publik), që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-ISSAI 400 (Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë), që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

-ISSAI 4000 "Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;



- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) që zbatohen nga anëtarët e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve/IFAC;
- Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*”; etj.;
- Praktikat më të mira të fushës.

## **8. Metodatat e auditimit.**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar/MAS funksion në fushën e sportit në zbatim të Ligji Nr. 79/2017 “*Për sportin*” i ndryshuar dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021”*Për kriteret e mënyrat e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre*”. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. *Intervistimi*- duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave/dokumenteve përkatëse;
- b. *Baza e të dhënave/data baza e krijuar nga subjekti mbi shpërblimet e dhëna për sportistët elitar*- duke marrë informacionet e duhura në lidhje me procedurat e ndjekura për shpërblimin e sportistëve elitar;
- c. *Verifikimi i dokumentacionit fizik*-me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

## **9. Dokumentimi i auditimit.**

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave/dosjeve fizike të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e MAS-it, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në aktkonstatimet dhe aktverifikimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti përfundimtar auditimi.

## **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

### **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM.**

MAS, funksionon në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar dhe akteve në zbatim të tij, Ligjit Nr. 79/2017 “*Për sportin*” i ndryshuar dhe akteve në zbatim të tij, si dhe Rregullores së brendshme miratuar me Urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Sporteve Nr.352,

datë 17.06.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”.

Ministria përgjegjëse për arsimin është institucioni që realizon programin qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, ndërsa ministria përgjegjëse për sportin harton dhe zbaton politikën shtetërore në fushën e sportit, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive, bashkëpunon me organet e vetëqeverisjes vendore për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, etj.

## **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:**

### **2.1 Mbi dhënien e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë.**

Në zbatim të pikës II/1 të programit të auditimit Nr. 895/1 datë 14.10.2022”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Praktikat mbi dhënien e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, për periudhën 01.01.2022 deri me 30.06.2022.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

-Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

-VKM Nr.789, datë 15.12.2021”Për kriteret e mënyrat e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre”.

-Urdhri i ministrit të Arsimit dhe Sporteve Nr.352, datë 17.06.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”.

Auditimi është i llojit tematik, dhe u fokusua konkretisht në kriteret e ndjekura nga MAS për mënyrat e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre si dhe, në problematika të dala gjatë auditimit.

Bazuar në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, neni 27, parashikon për sportistët që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, trajtimin, shpërblimin, sipas rezultateve sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare dhe veprimtari kombëtare zyrtare. Kriteret, mënyra e shpërblimit dhe trajtimit të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Një gjë e tillë gjen rregullim ligjor dhe me VKM Nr.789, datë 15.12.2021”Për kriteret e mënyrat e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre”, pika 3, sportistët që gëzojnë statusin e nivelit të lartë, përfitojnë shpërblim dhe trajtim, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

Në zbatim të akteve ligjore e nënligjore të sipërcituara, për periudhën 01.01.20221 deri me 31.12.2021, referuar të urdhrave të titullarit për dhënien e shpërblimit sportistëve elitare dhe trajnerëve të tyre të marrë nga MAS (*burimi i të dhënave*), janë dhënë shpërblime në vlerën 14,600,000 lekë, në total ndërsa për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022 janë dhënë shpërblime në vlerën 55,588,800 lekë në total.

Nga auditimi i **njëpasnjëshëm i kërkesave/praktikave për shpërblim të sportistëve elitare dhe trajnerëve të tyre**, të vëna në dispozicion të grupit të auditimit në aspektin e përgjithshëm rezultoi:

<b>Titulli i gjetjes</b>	Mos përditësimi i Rregullores së brendshme, mungesa e specialistit të fushës në grupin e punës për shpërblimin e sportistëve elitare, etj. në procedurat e ndjekura për dhënien e shpërblimit sportistëve dhe trajnerëve të tyre.
<b>Situata</b>	<p><b>1-</b>Rregullorja e brendshme e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk është e përditësuar me ndryshimet që ka pësuar struktura organike miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.144, datë 16.12.2021 "<i>Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë</i>" për pasojë, nuk parashikon përshkrime pune për drejtoritë përkatëse në aspektin e përgjithshëm dhe atë specifik. Konkretisht, Drejtoria e Politikave të Sportit, e cila ka në përbërje të saj Sektorin e Zhvillimit të Sportit Elitar, nuk parashikon përshkrime pune/procedura për dhënien e shpërblimit sportistëve elitare, ashtu sikurse nuk parashikon në aspektin e përgjithshëm detyrat dhe funksionet e sportit brenda Drejtorisë dhe sektorëve përgjegjës të sportit, që lidhen në mënyrë organike me zhvillimin e sportit.</p> <p>Drejtoria/Sektori në këtë rast, ndjek si procedurë të formalizuar dhe jo të miratuar, shqyrtimin dhe trajtimin kërkesave që vijnë nga federatat përkatëse në të cilën përfshihet sportisti dhe trajneri i tij, pas adresimit të saj në MAS.</p> <p><b>2-</b> Grupi i punës, që merret me trajtimin e kërkesave për shpërblimin e sportistëve elitare, nuk ka në përbërje një specialist të fushës (<i>llojit të sportit për të cilin aplikohet për shpërblim</i>) dhe kur nuk ka të tillë, të kontraktojë sipas akteve ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie. Aktualisht kjo procedurë fillon me delegimin e kërkesës për shqyrtim dhe trajtim nga drejtoria/sektori përkatës, procedurë dhe pse është e formalizuar ajo nuk është e rregulluar si përshkrim pune në aktet e brendshme siç është rregullore e brendshme e institucionit.</p> <p><b>3-</b>Drejtoria e Politikave të Sportit nuk ka të miratuar një bazë të dhënash/data bazë tip, ku të japë të dhëna dhe përditësojë urdhrin e ministrit për miratimin e shpërblimit të sportistëve elitare, numrin e sportistëve elitare që përfitojnë shpërblim, llojin e sportit, kampionatin ku kanë marrë pjesë, sportin konkret dhe vlerën e shpërblimit.</p> <p>Një praktikë e tillë po ndiqet nga Janari 2022, ku ka një bazë të dhënash të krijuar formalisht nga Drejtoria e Politikave të Sportit, por që nuk është përfshirë si proces pune/përshkrim pune dhe miratuar në rregulloren e brendshme apo miratuar si formati tip i kësaj baze të dhënash.</p> <p><b>4-</b>Praktikat e aplikimit për dhënie shpërblimi për sportistët elitare, nuk janë të administruara në dosje të inventarizuara me dokumentacionin përbërës dhe të protokolluara sipas legjislacionit "Për arkivat".</p> <p><b>5-</b> Në Ligjin Nr. 79/2017 "<i>Për sportin</i>" i ndryshuar dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021 akte të cilat rregullojnë të drejtën e dhënies së shpërblimit për sportistët që gëzojnë statusin e nivelit të lartë/elitar, nuk parashikohet asnjë afat ligjor në të cilën kalon kjo procedurë e cila përfshin disa etapa, duke filluar nga shpallja e rezultateve zyrtare, përgjigja zyrtare për testet antidoping nga organizmat përkatës njohura me ligj deri në finalizimin për dhënie e shpërblimit. Gjithashtu ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,</p>

	<p>nuk parashikon të drejtën e ankimit dhe organin që e shqyrton, në rastet kur kërkesa për shpërblim nuk pranohet, nuk merret në shqyrtim apo refuzohet.</p> <p>Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, neni 27, pika 1, germa “c” përcakton në mënyrë eksplicite: “sportistët e sporteve individuale, sipas federatave përkatëse, përfitojnë këtë status për klasifikime në veprimtaritë ndërkombëtare referuar parashikimeve të pikës 1, shkronjave “a” dhe “b” të këtij neni, sipas përcaktimeve në rregulloret ndërkombëtare të këtyre veprimtarive”. Në kuptimin literal dhe logjik, ligji nuk ka përcaktuar qartë konkretisht cilat janë veprimtaritë ndërkombëtare të parashikuara në pikën 1, germa ”a” dhe ”b”, në rastet e sporteve individuale për të cilat si rregullimin ligjor të tyre, duhet referuar rregulloreve ndërkombëtare të këtyre veprimtarive. Gjithashtu dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021 nuk parashikon një klasifikim të tillë. Për rrjedhojë, përcaktimi i saktë i eventeve për të cilat ligji parashikon shpërblim duhet të jetë i shprehur në mënyrë konkrete dhe jo referues siç është shprehur në nenin 27, pika 1, germa “c” e ligjit.</p>
<b>Kriteri</b>	<p>-Urdhri Kryeministrit nr.144, datë 16.12.2021 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë",</p> <p>-Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, neni 27, pika 1, germa “c”,</p> <p>-VKM Nr.789, datë 15.12.2021.</p>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	<p>- mungesa e përshkrimeve të proceseve të punës për drejtoritë përkatëse në aspektin e përgjithshëm dhe atë specifik,</p> <p>-mungesa e një grupi pune në përbërje të të cilit të jetë specialist i fushës në trajtimin e kërkesave për shpërblimin e sportistëve,</p> <p>-mungesa e një bazë të dhënash/data bazë tip të miratuar në procedurën e shpërblimit të sportistëve elitare, me qëllim transparencën dhe auditimin e tyre,</p> <p>-mos inventarizimi i dosjeve me dokumentacionin përkatës për shpërblimin e sportistëve elitare dhe të protokolluara sipas legjislacionit “Për arkivat”,</p> <p>-mos parashikimi i afateve ligjore në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, në të cilën kalon procedura e shpërblimit të sportistëve elitare, duke filluar nga shpallja e rezultateve zyrtare, përgjigja zyrtare për testet antidoping nga organizmat përkatës njohura me ligj deri në finalizimin për dhënie e shpërblimit, si dhe mos parashikimi i të drejtën së ankimit dhe organit që e shqyrton, në rastet kur kërkesa për shpërblim nuk pranohet, nuk merret në shqyrtim apo refuzohet.</p>
<b>Shkaku</b>	<p>-Mos përditësimi i rregullores së brendshme me ndryshimet strukturore,</p> <p>-mos zbatimi i Ligjit “Për arkivat”,</p> <p>-boshllëku ligjor në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, neni 27, pika 1, germa ”a”, ”b dhe “c”</p>
<b>Rëndësia</b>	I mesëm
<b>Rekomandimi</b>	<p>-Të merren masa nga titullari i institucionit MAS për përditësimin e rregullores së brendshme të funksionimit me ndryshimet e reja strukturore duke përcaktuar qartë përshkrimin e proceseve të punës për drejtoritë përkatëse, specifikisht ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës për shqyrtimin dhe vlerësimin e shpërblimit për sportistët elitare ku në përbërje të jetë specialisti i fushës, si dhe miratimin si pjesë integrale të rregullores së data bazës së të dhënave për shpërblimin e sportistëve elitare.</p> <p>-Të merren masa nga MAS-i për propozimin për përmirësimin e</p>

	<p>legjislacionit për sportin duke bërë shtesat e nevojshme në ligj për vendosjen e afateve ligjore nëpër të cilën kalon procedura e shpërblimit të sportistëve elitare, duke filluar nga shpallja e rezultateve zyrtare, përgjigja zyrtare për testet antidoping nga organizmat përkatës njohura me ligj deri në finalizimin për dhënien e shpërblimit, si dhe parashikimin e të drejtës së ankimit dhe organit që e shqyrton, në rastet kur kërkesa për shpërblim nuk pranohet, nuk merret në shqyrtim apo refuzohet.</p> <p>-Të merren masa nga Nëpunësi Zbatues për procesin e inventarizimit të praktikave/dosjeve për shpërblimin e sportistëve elitare.</p>
--	--

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur (*jashtë afatit 7 ditor të parashikuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit*) observacion nga z. J.GJ, z. A.K dhe znj. V.Sh, me shkresë Nr. 6367/7, datë 15.12.2022, protokolluar në KLSH me Nr. 895/4, datë 19.12.2022, “*Në lidhje me Aktkonstatimin Nr.1, datë 30.11.2022*” si dhe observacionet nga z. J.GJ, z. A.K “*Kthim përgjigje projekt-raportin e Auditimit Tematik të Përputhshmërisë...*” me shkresë Nr. 6367/10 datë 29.12.2022, protokolluar në KLSH me Nr. 895/6, datë 29.12.2022 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**1.Pretendimet e subjektit:** “*Ju informojmë se rregullorja e MAS është përditësuar me urdhër nr.689, datë 15.11.2022 ku drejtorja e Politikave të Sportit ka një nen të dedikuar ku përcaktohen detyrat dhe funksione të sektorëve përkatës*”.

**2.** “*...Trajtimi i kërkesave për shpërblime të sportistëve elitare është detyrë funksionale e sektorit të zhvillimit të sportit elitare...*”.

**3.** “*...referuar rekomandimeve përkatëse (cituar në projekt-raport) ju sqarojmë se: Lidhur me rekomandimin 1.1. Ju informojmë se rregullorja e MAS është përditësuar me urdhër nr.689, datë 15.11.2022 ku drejtorja e Politikave të Sportit...*”.

**4.** “*...Lidhur me rekomandimin 1.2 përsa i takon afatit ligjor për kryerjen e të gjitha procedurave për shpërblimin e sportistit dhe trajnerit të tij... shprehemi dakord që të reflektohen ndryshimet në aktet ligjore*”.

**1.Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Lidhur pretendim 1 dhe 3, grupi i auditimit sqaron se nuk është bashkëlidhur nga subjekti ekstrakti i rregullores me detyrat e përcaktuara të Drejtorisë së Politikave të Sportit dhe sektorëve në varësi, me qellim vlerësimin dhe dhënien e një opinionit nëse kjo rregullore përmbush rekomandimet e KLSH. Sa më sipër, kjo pjesë e observacionit **nuk merret parasysh.**

**2.** Lidhur me këtë pretendim, grupi i auditimit sqaron se, duke qenë detyrë funksionale e këtij sektori procesi i punës duhet të jetë i përshkruar dhe në rregullore si përshkrim pune specifik dhe për më tepër në këtë proces pune të jetë i përfshirë dhe një specialist fushe. Sa më sipër, kjo pjesë e observacionit **nuk merret parasysh**

**Nga auditimi i njëpasnjëshëm i kërkesave/praktikave për shpërblim të sportistëve elitare dhe trajnerëve të tyre,** të vëna në dispozicion të grupit të auditimit konkretisht rezultoi:

1.Me kërkesën nr.539 prot., datë 21.12.2021 protokolluar në MAS me nr.7341, datë 28.12.2021 Federata shqiptare e bodybuilding & fitness (*këtu e më poshtë Federata*) ka kërkuar shpërblimin e sportistit M.M dhe trajnerit të tij A.F, të federuar pranë saj, për rezultate të larta ndërkombëtare, bashkëlidhur kërkesës dokumentet për marrjen e titullit dhe vlerësimet e bëra nga struktura shtetërore për rezultatet e arritura.

-Referuar kërkesës së Federatës, z. M.M është shpallur në eventin:

**Kampionatin “IFBB WORLD CHAMPIONSHIP ELITE PRO-IFBB Diamond Cup”**

-kategoria Classic bodybuilding-180 cm- **vendi i parë**

-kategoria Classic bodybuilding open - **vendi i katërt**

dhe në:

### Kupa e Shqipërisë

- kategoria bodybuilding-80 kg- **vendi i parë**

- kategoria bodybuilding Absolut- **vendi i parë**

-Në përgjigje të shkresës së sipërme, MAS me shkresën nr. 7341/1 prot., datë 15.03.2022 i bën me dije Federatës se “Vendimi nr.789 i Këshillit të Ministrave datë 15.12.2021 “Për kriteret, e mënyrat e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre”, **nuk ka parashikuar** shpërblim për aktivitetin “Turne Botëror”.

-Federata me shkresën nr.46 prot., datë 30.03.2022 drejtuar ish Sekretarit të Përgjithshëm të MAS z. A.K, Drejtorit të Sporteve z. J.GJ, ish Drejtorit Juridik z. E.T dhe për dijeni ministrit znj. E.K, kërkon ndjesë dhe sqaron në lidhje me **lapsusin** në emërtim, duke “përcaktuar qartë se nuk bëhet fjalë për **turne**, por për **kampionat** të mirëfilltë statik të organizuar në pre-eliminare dhe në finale sipas kategorive siç është përcaktuar që në titull “Championship.....”.

<b>Titulli i gjetjes</b>	Mos administrim dhe mungesë dokumentacioni në praktikën e shpërblimit për sportistin M.M.
<b>Situata</b>	<p>Shkresa e sipërcituar e Federatës (nr.46 prot., datë 30.03.2022), <b>nuk rezulton</b> të jetë bashkëlidhur praktikës vënë në vënë dispozicion të grupit të auditimit dhe as të jetë e administruar në zyrën e protokollit, veprim jo në përputhje me Rregulloren e brendshme Kreu IV, neni 21, pika 2 ku citohet:</p> <p><i>“Të gjitha shkresat zyrtare, letrat e dërguara nga populli,....që drejtohen dhe hyjnë në institucion, pavarësisht nga mënyra e dërgimit të tyre, dorëzohen për regjistrim në zyrën e protokollit”.</i></p> <p>Për rrjedhojë, nga MAS <b>nuk është kthyer</b> përgjigje, pasi nuk ka asnjë gjurmë nëse është marrë në shqyrtim ose jo kërkesa, dhe nëse është protokolluar në këtë institucion.</p> <p>-Mos marrja në konsideratë nga MAS e kërkesës për shkaqet e përmendura në të si dhe nga mungesa e një përgjigje kundrejt shkresës së Federatës nr. 46 prot., datë 30.03.2022, ka lindur detyrimin e sportistit M.M të ushtrojë ankesë pranë KLSH pa nr. pa datë, protokolluar në KLSH nr.703, datë 14.07.2022 si dhe pranë Avokatit të Popullit me shkresën depozituar datë 18.07.2022.</p> <p>-Me shkresën nr.K 1/M9-2 Prot, datë 30.08.2022 Avokati i Popullit i rekomandon MAS-it “<u>marrjen e masave të menjëhershme për vijimin e procedurës për njohjen e të drejtës dhe shpërblimin e z. M.M ...</u>”</p> <p>-MAS-i me shkresën nr. 5639/1 prot., datë 13.10.2022 drejtuar Avokatit të Popullit dhe për dijeni z. M.M, bën me dije se:</p> <p>Vendimi nr.789 i Këshillit të Ministrave datë 15.12.2021 “Për kriteret, e mënyrat e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre”, nuk ka parashikuar shpërblim të aktivitetit ndërkombëtar “IFBB DIAMOND CUP PORTUGAL &amp; IFBB ELITE PRO WORLD CHAMPIONSHIPS” por vetëm shpërblim për Kampionatin Botëror European, etj. në sportin përkatës”. Për sa sipër, kërkesa e sportistit M.M nuk plotëson kriteret e përcaktuara në aktin ligjor të lartpërmendur”.</p> <p>Në këto kushte, nga MAS është refuzuar kërkesa për shpërblim me argumentin e sipërcituar.</p> <p>-Përgjigja e kërkesës së sipërcituar, nuk është bërë në përputhje me Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, neni 27, pika 1, germa “c”, pasi</p>

	<p>nuk i referohet saktësisht përcaktimeve ligjore të këtij neni, ku në asnjë rast nga MAS nuk rezulton të jetë bërë verifikimi apo dhe të jetë shprehur në arsyetimin e kthimit të përgjigjes, që referuar rregulloreve ndërkombëtare të këtyre veprimtarive, nuk figuron që kampionati “IFBB DIAMOND CUP PORTUGAL &amp; IFBB ELITE PRO WORLD CHAMPIONSHIPS” (i cili në kuptimin e përgjithshëm përfshihet në termin “kampionat botëror”) të jetë i përfshirë si event për të cilin ligji për sportet dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021 nuk parashikon dhënien e shpërblimit.</p> <p>-Nuk rezulton që të jetë kërkuar nga ana e MAS plotësim dokumentacioni sipas kërkesave të VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13 në lidhje me rezultatet përfundimtarë të analizave antidoping. (Praktika trajtuar dhe pranuar nga znj. V.Sh, z. A.K dhe J.G.J)</p>
<b>Kriteri</b>	<p>-Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, neni 27, pika 1, germa “c”, -VKM Nr.789, datë 15.12.2021, - Rregullore e brendshme Kreu IV, neni 21, pika 2. - Shkresa nr.46 prot., datë 30.03.2022</p>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	<p>-Mos shqyrtimi i kërkesës nr.46 prot., datë 30.03.2022 të Federatës; -nuk është bërë verifikimi apo dhe të jetë shprehur në arsyetimin e kthimit të përgjigjes, (shkresa nr. 5639/1 prot., datë 13.10.2022) që eventit për të cilin kërkohet shpërblimi të jetë ose jo i përfshirë në eventet për të cilin Ligji Nr.79/2017 i ndryshuar dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021 parashikon ose jo shpërblim.</p>
<b>Shkaku</b>	<p>-Mos administrimi i shkresës së Federatës nr.46 prot., datë 30.03.2022 nga MAS; -mos interpretim i saktë i Ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar nenin 27, pika 1, germa “c”.</p>
<b>Rëndësia</b>	E mesme
<b>Rekomandimi</b>	<p>-Të merren masa nga MAS për shqyrtimin e kërkesës së Federatës nr.46 prot., datë 30.03.2022 për shpërblimin e sportistit M.M në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar. -Të merren masa nga MAS për propozimin për përmirësim ligjor të legjislacionit për sportet duke kërkuar shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, konkretisht të nenit 27, pika 1, germa “c”, me qëllim përcaktimin e saktë të të gjithë eventeve të listuara për të cilat ligji njeh të drejtën e shpërblimit.</p>

**Konkluzion:** Nga ana MAS-it, refuzimi i kërkesës për shpërblim i sportistit M.M dhe trajnerit të tij është jo në përputhje me kriteret e parashikuara nga Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, neni 27, pika 1, germa “c”, VKM Nr.789, datë 15.12.2021”Për kriteret e mënyrat e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre”, pika 13 dhe Urdhri i ministrit të Arsimit dhe Sporteve Nr.352, datë 17.06.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë” Kreu IV, neni 21, pika 2, pasi:

☞ nuk është marrë në shqyrtim kërkesa e Federatës nr.46 prot., datë 30.03.2022 ku sqarohet në mënyrë specifike klasifikimi i eventit për të cilin është shpallur fitues sportisti,

☞kthimi përgjigjes nga ana e MAS-it drejtuar Avokatit të Popullit ashtu dhe kërkuarit/sportistit, nuk është bërë në përputhje me Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, neni 27, pika 1, germa “c”, pasi nuk i referohet saktësisht përcaktimeve ligjore të këtij neni, duke mos bërë verifikimin e eventit referuar rregulloreve ndërkombëtare të këtyre

veprimtarive, për kampionatin “IFBB DIAMOND CUP PORTUGAL & IFBB ELITE PRO WORLD CHAMPIONSHIPS”,

☞ nuk rezulton që të jetë kërkuar nga ana e MAS plotësim dokumentacioni sipas kërkesave të VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13 në lidhje me rezultatet përfundimtarë të analizave antidoping.

☞ specialistët e Sektorit të Zhvillimit të Sportit Elitar, të cilët kanë trajtuar dhe shqyrtuar kërkesën e Federatës, nuk kanë patur në përbërje dhe një specialist të fushës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur (*jashtë afatit 7 ditor të parashikuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit*) observacion nga z. J.GJ, z. A.K dhe znj. V.Sh, me shkresë Nr. 6367/7, datë 15.12.2022, protokolluar në KLSH me Nr. 895/4, datë 19.12.2022 “*Në lidhje me Aktkonstatimin Nr.1, datë 30.11.2022*”, si dhe observacionet nga z. J.GJ, z. A.K “*Kthim përgjigje projekt-raportin e Auditimit Tematik të Përputhshmërisë...*” me shkresë Nr. 6367/10 datë 29.12.2022, protokolluar në KLSH me Nr. 895/6, datë 29.12.2022ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**1.Pretendimet e subjektit:** “.....Drejtorja e Sportit ka zbatuar me rigorozitet aktet ligjore dhe nënligjore për shpërblimin e të gjithë sportistëve.....Çdo interpretim në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore, si në rastin konkret, do të ishte abuziv dhe shkelje e akteve të lartpërmendura ....”.

2....”*Lidhur me rekomandimin 2.1 sqarojmë se aktivitet ndërkombëtare në nivel rajonal ndërkombëtar etj. janë përcaktuar qartësisht në nenin 27... si dhe parashikimet e pikës 1 germa a dhe b...*”.

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Lidhur pretendimin 1, grupi i auditimit sqaron dhe njëherë se, KLSH konstaton mangësi në procedurën e ndjekur në shqyrtimin e kërkesës së sportistit M.M. Sa më sipër, kjo pjesë e observacionit **nuk merret parasysh.**

2. Lidhur pretendimin 2, grupi i auditimit sqaron dhe njëherë se germa ”c” e nenit 27 të Ligjit Nr. 79/2017 “*Për sportin*” i ndryshuar citon qartë se “sportistët e sporteve individuale, sipas federatave përkatëse, përfitojnë këtë status për klasifikime në veprimtaritë ndërkombëtare referuar parashikimeve të pikës 1, shkronjave “a” dhe “b” të këtij neni, sipas përcaktimeve në rregulloret ndërkombëtare të këtyre veprimtarive”, pra kërkohet referimi tek rregulloret ndërkombëtare ndërkohë që duhet të përcaktohen qartë rregulloret që përfshijnë këto evente. Sa më sipër, kjo pjesë e observacionit **nuk merret parasysh.**

2.Me Urdhrin Nr. 210, datë 21.04.2022 të ministrit të Arsimit dhe Sporteve znj. E.K, është shpërblyer diferenca (*praktikë që ka filluar në 2021*) për sportistin B.C, fitues i vendit të katërt në stilin e shköputjes, vendit të dytë në stilin e shtytjes dhe vendit të tretë në dygarësh në Kampionatin European të Peshëngritjes për të rritur zhvilluar në Moskë/Rusi më datë 03-11.04.2021 në shumën 2,100,000 lekë, dhe trajneri G.T në shumën 840,000 lekë, shpërblimin e sportistit B.C, fitues i vendit të parë në stilin e shköputjes, vendin e dytë në stilin e shtytjes dhe vendit të dytë në dygarësh, në Kampionatin Botëror të peshëngritjes zhvilluar në Uzbekistan 06-17.12.2021 në shumën 17,800,000 lekë dhe shpërblimin e trajnerit G.T në Kampionatin Botëror të peshëngritjes zhvilluar në Uzbekistan 06-17.12.2021 me shumën 7,120,000 lekë, në total shpërblimi në vlerën **27,860,000** lekë.

Kërkesa e Federatës shqiptare të peshëngritjes nr.156 prot., datë 12.04.2022 protokolluar në MAS me nr.2464, datë 12.04.2022, për shpërblimin e sportistëve E.Q, B.C, E.V, dhe K.Sh, për aktivitetet ndërkombëtare dhe kombëtare të vitit 2021, është në vijimësi të kërkesës së saj protokolluar në MAS respektivisht me nr.236, datë 14.01.2022 (për B.C), nr.7399, datë 31.12.2021 dhe nr. 4099, datë 14.06.2022 (për E.V), nr. 238, datë 14.01.2022 (për K.Sh).



<b>Titulli i gjetjes</b>	Parregullsi në administrimin e dokumentacionit të shpërblimit të sportistit B.C.
<b>Situata</b>	<p>-Praktika e shpërblimit për sportistin B.C nuk ka bashkëngjitur rezultatin/përgjigjen përfundimtare të testeve antidoping jo në përputhje me kërkesat e VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13, për sportisten E.V dhe K.Sh, ndërsa për sportistët B.C dhe E.Q bashkëlidhur kërkesës është vetëm rezultati për testin fillestar antidoping respektivisht në datat 06.04.2021 dhe datë 07.04.2021, por jo për testin përfundimtar pas përfundimit të eventit duke mos respektuar kërkesat ligjore për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar.</p> <p>-Praktika për shpërblimet e të gjithë sportistëve të listuar në kërkesën e Federatës protokolluar në MAS nr.2464, datë 12.04.2022 si dhe atyre respektive, nuk është lidhur me të gjithë dokumentacionin përkatës, apo të jetë krijuar si praktikë e veçantë për secilin sportist dhe trajnerin e tij, sipas kërkesës respektive së Federatës përkatëse, me qëllim auditimin e tyre apo vlerësimin e transaksionit financiar të kryer për këta sportistë. (Praktika trajtuar dhe pranuar nga Znj. V.Sh, z. A.K dhe Z.Gj)</p>
<b>Kriteri</b>	-VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Parregullsi në administrimin e dokumentacionit të shpërblimit
<b>Shkaku</b>	Mungesa e rezultatit/përgjigjes përfundimtare të testeve antidoping sipas kërkesave të pikës 13, VKM Nr.789, datë 15.12.2021.
<b>Rëndësia</b>	E ulët
<b>Rekomandimi</b>	Të merren masa nga Drejtoria e Politikave të Sportit/Sektori i Zhvillimit të Sportit Elitar për plotësimin e dokumentacionit të shpërblimit për sportistin B.C dhe inventarizimin e dosjes.

-Me Urdhrin Nr. 16, datë 19.01.2022 të ministrit të Arsimit dhe Sporteve znj. E.K, është shpërblyer sportisti B.C, për rezultatet e arritura në Kampionatin Evropian të Peshëngritjes për të rritur zhvilluar në Moskë/Rusi më datë 03.04.2021 në shumën 1,180,000 lekë dhe trajneri O.F, në shumën 472,000 lekë, gjithsej në vlerën **1,652,000** lekë dhe me Urdhrin Nr.348, datë 17.06.2022 është shpërblyer për rezultatet e arritura në Kampionatin Botëror të Peshëngritjes për të rritur zhvilluar në Uzbekistan datë 07-17.12.2021 në shumën 2,000,000 lekë dhe trajneri O.F, në shumën 800,000 lekë, gjithsej në vlerën **2,800,000** lekë.

<b>Titulli i gjetjes</b>	Parregullsi në administrimin e dokumentacionit të shpërblimit të sportistit B.C.
<b>Situata</b>	<p>-Dy urdhrat e sipërm (Nr. 348, datë 17.06.2022 dhe Nr. 16, datë 19.01.2022) për shpërblimin e sportistes E.V dhe pse janë vazhdim i praktikës në përgjigje të kërkesës së Federatës protokolluar në MAS me nr.2464, datë 12.04.2022, për aktivitetet e zhvilluara për vitin 2021 si dhe vijimësi e kërkesave respektive të Federatës për këtë sportiste protokolluar në MAS nr.7399, datë 31.12.2021 dhe nr.4098, datë 14.06.2022, <b>nuk kanë</b> bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin përkatës, konkretisht rezultatin/përgjigjen përfundimtare të testeve antidoping referuar veprimtarisë ndërkombëtare në të cilën sportisti ka marrë pjesë, jo në përputhje me kërkesat e VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13, dhe nëse për sportisten nuk ka rënë short për kryerjen e analizave, por bashkëlidhur praktikës duhet të ishte përgjigja e Federatës për konfirmin ose jo të kryerjes së këtyre testeve. (Praktika trajtuar dhe pranuar nga Znj. V.Sh, z. A.K dhe J.GJ)</p>

<b>Kriteri</b>	-VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Parregullsi në administrimin e dokumentacionit të shpërblimit
<b>Shkaku</b>	Mungesa e rezultatit/përgjigjes përfundimtare të testeve antidoping sipas kërkesave të pikës 13, VKM Nr.789, datë 15.12.2021.
<b>Rëndësia</b>	E ulët
<b>Rekomandimi</b>	Të merren masa nga Drejtoria e Politikave të Sportit/Spektori i Zhvillimit të Sportit Elitar për plotësimin e dokumentacionit të shpërblimit për sportistin B.C dhe inventarizimin e dosjes.

-Me Urdhrin Nr.269, datë 16.05.2022 është shpërblyer sportisti E.Q, në Kampionatin Evropian të Peshëngritjes për të rritur zhvilluar në Moskë/Rusi më datë 03-11.04.2021 në shumën 400,000 lekë dhe trajneri tij Z.K, në shumën 160,000 lekë, shpërblimin e sportistit E.Q, në Kampionatin Botëror të Peshëngritjes për të zhvilluar në Uzbekistan datë 07-17.12.2021 në shumën 4,600,000 lekë dhe trajneri Z.K, në shumën 1,840,000 lekë, gjithsej në vlerën **7,000,000** lekë.

<b>Titulli i gjetjes</b>	Parregullsi në administrimin e dokumentacionit të shpërblimit të sportistit E.Q.
<b>Situata</b>	Praktika nuk ka bashkëngjitur jo në përputhje me kërkesat e VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13, kërkesën e Federatës protokolluar në MAS nr.237 prot, datë 14.01.2022 mbi bazën e të cilës ka filluar procedurën e shpërblimit, si dhe përgjigjen e rezultatit përfundimtar të testeve antidoping shoqëruar dhe me rezultatin përfundimtar të arritur nga sportisti. <b>Pas observacionit të subjektit u vu në dispozicion e-mail-i nga MAS ku kërkohet plotësimi i dokumentacionit nga federata, por dokumentacioni duhet bashkëngjitur praktikës në mënyrë që të jetë konform kërkesave të VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13.</b> <i>(Praktika trajtuar dhe pranuar nga Znj. V.Sh, z. A.K dhe J.G.J)</i>
<b>Kriteri</b>	-VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Parregullsi në administrimin e dokumentacionit të shpërblimit
<b>Shkaku</b>	Mungesa e kërkesës së Federatës për shpërblim si dhe rezultati/përgjigja përfundimtare e testeve antidoping sipas kërkesave të pikës 13, VKM Nr.789, datë 15.12.2021.
<b>Rëndësia</b>	E ulët
<b>Rekomandimi</b>	Të merren masa nga Drejtoria e Politikave të Sportit/Spektori i Zhvillimit të Sportit Elitar për plotësimin e dokumentacionit të shpërblimit për sportistin E.Q dhe inventarizimin e dosjes.

-Me Urdhrin Nr.497, datë 20.12.2021 është shpërblyer sportisti A.Q, në Kampionatin Botëror të Boksit për të rritur zhvilluar në Beograd/Serbi më datë 22.10-07.11.2021 në shumën 4,000,000 lekë dhe trajneri tij S.B, në shumën 1,600,000 lekë, gjithsej në vlerën **5,600,000** lekë.

<b>Titulli i gjetjes</b>	Parregullsi në administrimin e dokumentacionit të shpërblimit të sportistit A.Q.
<b>Situata</b>	Praktika nuk ka bashkëngjitur jo në përputhje me kërkesat e VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13: - kërkesën e Federatës protokolluar në MAS nr.6542 prot, datë 16.11.2021 mbi bazën e të cilës ka filluar procedurën e shpërblimit, -nuk ka përgjigjen e rezultateve fillestar dhe përfundimtar të testeve

	antidoping shoqëruar -nuk ka rezultatin përfundimtar të konfirmuar të arritur nga sportisti. (Praktika trajtuar dhe pranuar nga Znj. V.Sh, z. A.K)
<b>Kriteri</b>	-VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Parregullsi në administrimin e dokumentacionit të shpërblimit
<b>Shkaku</b>	Mungesa e kërkesës së Federatës për shpërblim si dhe rezultati/përgjigja përfundimtare e testeve antidoping sipas kërkesave të pikës 13, VKM Nr.789, datë 15.12.2021.
<b>Rëndësia</b>	E ulët
<b>Rekomandimi</b>	Të merren masa nga Drejtoria e Politikave të Sportit/Sektori i Zhvillimit të Sportit Elitar për plotësimin e dokumentacionit të shpërblimit për sportistin A.Q dhe inventarizimin e dosjes.

### **Konkluzion:**

Për vitin 2021 deri në 30.06.2022, në procedurën e ndjekur nga MAS për dhënien e shpërblimit sportistëve elitar dhe trajnerëve të tyre, që përfitojnë këtë të drejtë nga Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar si dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021 rezultoi se:

☞ Rregullorja e brendshme e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk është e përditësuar me ndryshimet që ka pësuar struktura organike miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.144, datë 16.12.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë” pasi, nuk parashikon përshkrime pune për drejtoritë përkatëse në aspektin e përgjithshëm dhe atë specifik.

☞ Trajtimi i kërkesave për shpërblimin e sportistëve elitar nuk bëhet nga grup pune, në përbërje të të cilit të jetë një specialist i fushës (llojit të sportit për të cilin aplikohet për shpërblim) dhe kur nuk ka të tillë, të kontraktojë sipas akteve ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie.

☞ Nuk ka të miratuar një bazë të dhënash/data bazë tip, ku të jepen dhe përditësohen të dhëna mbi urdhrin e ministrit për miratimin e shpërblimit të sportistëve elitar, numrin e sportistëve elitar që përfitojnë shpërblim, llojin e sportit, kampionatin ku kanë marrë pjesë, sportin konkret dhe vlerën e shpërblimit.

☞ Praktikave të aplikimit për dhënie shpërblimi për sportistët elitar, nuk janë të administruara në dosje të inventarizuara me dokumentacionin përbërës dhe të protokolluar sipas legjisllacionit “Për arkivat”.

☞ Në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021 që rregullojnë të drejtën e dhënies së shpërblimit për sportistët që gëzojnë statusin e nivelit të lartë/elitar, nuk parashikohet afat ligjor për këtë procedurë e cila përfshin disa etapa, duke filluar nga shpallja e rezultateve zyrtare, përgjigja zyrtare për testet antidoping nga organizmat përkatës njohura me ligj deri në finalizimin për dhënie e shpërblimit. Gjithashtu ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, nuk parashikon të drejtën e ankimit dhe organin që e shqyrton, në rastet kur kërkesa për shpërblim nuk pranohet, nuk merret në shqyrtim apo refuzohet.

☞ Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, neni 27, pika 1, germa “c”, si dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021, në kuptimin literal, nuk përcakton qartë konkretisht cilat janë veprimtaritë ndërkombëtare të parashikuara në pikën 1, germa “a” dhe “b”, në rastet e sporteve individuale për të cilat si rregullimin ligjor të tyre, duhet referuar rregulloreve ndërkombëtare të këtyre veprimtarive.

-Nga auditimi i praktikave të ndjekura për shpërblimin e sportistëve elitar konkretisht i kërkesës së Federatës së shqiptare të bodybuilding & fitnes për shpërblimin e sportistit M.M dhe trajnerit të tij, refuzimi i kërkesës nga ana e MAS-it është jo në përputhje me kriteret e parashikuara nga Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, neni 27, pika 1, germa “c”, VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13 dhe Urdhri i ministrit

të Arsimit dhe Sporteve Nr.352, datë 17.06.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë” Kreu IV, neni 21, pika 2, pasi:

☞ nuk është marrë në shqyrtim kërkesa e Federatës nr.46 prot., datë 30.03.2022 mbi interpretimin e eventit për të cilin është shpallur fituesi,

☞ kthimi përgjigjes nga MAS-i drejtuar si Avokatit të Popullit ashtu dhe kërkuesit/sportistit, nuk është bërë në përputhje me Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, neni 27, pika 1, germa “c”, pasi nuk i referohet saktësisht përcaktimeve ligjore të këtij neni, duke mos bërë verifikimin e eventit referuar rregulloreve ndërkombëtare të këtyre veprimtarive, për kampionatin “IFBB DIAMOND CUP PORTUGAL & IFBB ELITE PRO WORLD CHAMPIONSHIPS”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur (*jashtë afatit 7 ditor të parashikuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit*) observacion nga z. J.GJ, z. A.K dhe znj. V.Sh, me shkresë Nr. 6367/7, datë 15.12.2022, protokolluar në KLSH me Nr. 895/4, datë 19.12.2022, “Në lidhje me Aktkonstatimin Nr.1, datë 30.11.2022”, si dhe observacionet nga z. J.GJ, z. A.K “Kthim përgjigje projekt-raportin e Auditimit Tematik të Përputhshmërisë...” me shkresë Nr. 6367/10 datë 29.12.2022, protokolluar në KLSH me Nr. 895/6, datë 29.12.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**1.Pretendimet e subjektit:** “.....Drejtorja e Sportit, konfirmon se të gjitha kërkesat ose praktikrat e shpërblimeve për sportistët elitar janë të shoqëruara me memon përkatëse, rezultatin e klasifikimit përfundimtar si dhe informacionet e nevojshëm mbi kontrollin antidoping”.

2.”... Lidhur me rekomandimin 2.1 Drejtorja e Sportit konfirmon se të gjitha kërkesat e shpërblimeve për sportistët elitar janë të shoqëruara me memon ....

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Lidhur me këto pretendime, grupi i auditimit sqaron se, pasi shqyrtoi dokumentacionin bashkëngjitur observacionit, i cili nuk u vu në dispozicion gjatë periudhës së auditimit e **merr në konsideratë** duke reflektuar qëndrimin në këtë Raport Përfundimtar auditimi. Konstatimet e tjera janë pranuar nga subjekti.

## 2.2.2 Çështje të ndryshme të dala gjatë auditimit.

-Në zbatim të pikës të II/2 të Programit të Auditimit “Çështje të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit” në lidhje me ankesën datë 26.09.2022 depozituar në KLSH me nr.874 prot., datë 27.09.2022 nga Kryetari i Federatës Sindikale të Arsimit të Shqipërisë/Shkolla e mesme e bashkuar Orenjë-Librazhd, z. H.B për mos rimbursimin e plotë të çmimit të biletës së transportit të mësuesve që udhëtojnë në linjën Librazhd-Gorenjë dhe anasjelltas, u krye verifikimi në ambientet e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Librazhd.

Objekti i verifikimit:

-Ankesa datë 26.09.2022 e depozituar në KLSH me nr.874 prot., datë 27.09.2022 nga Kryetari i Federatës Sindikale të Arsimit të Shqipërisë/Shkolla e mesme e bashkuar Orenjë-Librazhd, z. H.B.

Nga verifikimi rezultoi:

-Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Librazhd me shkresën nr. 460 prot., datë 17.03.2022 i është drejtuar MAS-it si dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë, duke vënë në dukje shqetësimin për pagesën e transportit të mësuesve, pasi në ZVAP Librazhd janë

paraqitur kërkesa nga mësues të disa shkollave në lidhje me çmimin e biletës së transportit që ata paguajnë sot e cila është dyfishuar me rritjen e çmimit të naftës.

-Me shkresën Nr.1860/1 prot., datë 31.3.2022 (administruar nga verifikimi në ZVAP Librazhd) MAS-i i kthen përgjigje ZVAP Librazhd dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë si dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Tiranë ku i bëjnë me dije detyrimet e përcaktuara në VKM Nr. 682, datë 29.07.2015 i ndryshuar.

-Me shkresën Nr.747/1 prot., datë 28.4.2022 (administruar nga verifikimi në ZVAP Librazhd) ZVAP-ja i kthen përgjigje SHMB Orenj, 9 vjeçare Funarerës, Zdrajsh ku i bën me dije detyrimet që rrjedhin nga VKM Nr. 682, datë 29.07.2015 i ndryshuar në lidhje me shpenzimet e transportit të mësuesve.

-Me shkresën nr.1195/1, prot., datë 26.07.2022 të ZVAP Librazhd ka kthyer përgjigje ankuesit Federatës Sindikale të Arsimit të Shqipërisë/Shkolla e mesme e bashkuar Orenjë-Librazhd dhe për dijeni Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, duke vënë në dijeni se në zbatim të VKM Nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” i ndryshuar nga ZVAP Librazhd është zbatuar me përpikmëri dhe në kohë aktet ligjore dhe nënligjore për pagesën e transportit të punonjësve mësimorë.

VKM Nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” i ndryshuar, citon:

pika 3:

“Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar prokurojnë me fonde publike shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas rrjetit të linjave të transportit rrethqytetas, të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose qendrore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik”.

pika 4:

“Në rastet kur procedura e prokurimit publik të linjave të transportit në pikën 3 të këtij vendimi, nuk realizohet me sukses nga drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar, me autorizimin e kësaj të fundit, zyra vendore e arsimit parauniversitar siguron mbulimin e shpenzimeve për linjat e transportit të nxënësve dhe punonjësve të arsimit parauniversitar publik përfitues, ... deri në përfundim të vitit buxhetor”.

pika 5/1:

“Zyrat vendore të arsimit parauniversitar e njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë dhe koordinojnë të dhënat për numrin e përfituesve e largësitë nga vendbanimi dhe raportojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin, çdo 3 muaj”.

<b>Titulli i gjetjes</b>	Mos raportim i ZVAP Librazhd pranë MAS sipas kërkesave të VKM Nr. 682, datë 29.07.2015, pika 5/1 e ndryshuar.
<b>Situata</b>	Nga verifikimi rezulton se nga ZVAP Librazhd nuk ka raportin pranë MAS-it çdo 3 muaj në lidhje me numrin e përfituesve e largësitë nga vendbanimi por, referuar VKM nr.99 datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar” raportojnë 1 herë në vit mbi listën e pagesave për transportin e arsimtareve në mënyrë elektronike ose shkresore në DRAP Korçë.
<b>Kriteri</b>	-VKM Nr. 682, datë 29.07.2015, pika 5/1 e ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekt</b>	Mos raportim në MAS çdo 3 muaj
<b>Shkaku</b>	Mos respektimi i kërkesave të pikës pika 5/1 të VKM Nr. 682, datë

	29.07.2015.
<b>Rëndësia</b>	E ulët
<b>Rekomandimi</b>	Të merren masa nga ZVAP Librazhd për raportimin periodik 3 mujor në MAS në lidhje me numrin e përfituesve dhe largësitë nga vendbanimi.

-Nga verifikimi në mënyrë të përmblodhur likuidimet për vitin 2022 për transportin e mësuesve janë kryer si më poshtë referuar urdhër shpenzimeve respektive:

Viti 2022	Muaji	Urdhër shpenzimi Nr.	data	Nr. Mësuesve	Leke
Transport mësuesit	Janar-Shkurt	68,69,70,71,72,73	15.03.2022	303	1,530,661
Transport mësuesit	Mars	98,99,100,101,102	11.04.2022	302	993,453
Transport mësuesit	Prill	131,132,133,134,135	17.05.2022	300	1,058,016
Transport mësuesit	Maj	170,171,172,173,174	20.06.2022	297	975,371
Transport mësuesit	Qershor	204,205,206,207,208	14.07.2022	306	896,487
Transport mësuesit	Shtator	292,293,294,295,296	18.10.2022	286	857,962

Bazuar në VKM Nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” i ndryshuar me VKM Nr. 98, datë 9.02.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 682, datë 29.07.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, mbulimi i shpenzimeve të transportit për arsimtarët rregullohet nga pika 3 dhe pika 4 sipas së cilës:

“Në rastet kur procedura e prokurimit publik të linjave të transportit në pikën 3 të këtij vendimi, nuk realizohet me sukses nga drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar, me autorizimin e kësaj të fundit, zyra vendore e arsimit parauniversitar siguron mbulimin e shpenzimeve për linjat e transportit të nxënësve dhe punonjësve të arsimit parauniversitar publik përfitues, ... deri në përfundim të vitit buxhetor... Masa e shpenzimeve përllogaritet mbi bazën e numrit të ditëve mësimore, numrit të mësuesve, që janë paraqitur në punë, numrit të nxënësve, që kanë ndjekur mësimin, të çmimit të indeksuar me normën e inflacionit të biletës për linjat ndërqytetëse apo rrethqytetëse të transportit, të miratuara me vendimin Nr. 146, datë 26.2.1998 të Këshillit të Ministrave ... duke filluar nga data 1.1.2022”.

<b>Titulli i gjetjes</b>	Mos përputhje në çmimin e biletës së transportit ndërqytetës në Aneksin 1, Pasqyra 1, “Çmimet e biletave të transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” të VKM-së Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime dhe Aneksit 1 “Tabela e kilometrave dhe çmimi i biletave për linjat rrethqytetëse të Bashkisë Librazhd “(sektori i taksave) miratuar nga Bashkia Librazhd.
<b>Situata</b>	VKM Nr. 682, datë 29.07.2015 me ndryshime ka parashikuar se vetëm në rastet kur nuk realizohen procedurat e prokurimit publik, bëhet rimbushim i çmimit të biletës së transportit referuar gjatësisë së distancave etj. të përcaktuar në këtë VKM ku citohet: <b>Pika 2:</b> “Njësitë e vetëqeverisjes vendore miratojnë rrjetin e linjave të transportit, mbështetur në numrin e fëmijëve, nxënësve dhe të punonjësve të arsimit

	<p>parauniversitar publik, që planifikohen të përfitojnë nga ky shërbim, ... bazuar në informacionin që marrin nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar, brenda muajit tetor për vitin e ardhshëm buxhetor. Listat e përfituesve konfirmohen nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për distancën nga vendbanimi i përhershëm dhe dërgohen në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, për të realizuar procedurën e prokurimit publik brenda muajit nëntor, për vitin e ardhshëm buxhetor.”</p> <p><b>Pika 4:</b></p> <p>“Masa e shpenzimeve përlllogaritet në bazë të numrit të nxënësve dhe të mësuesve, numrit të ditëve mësimore, <b>çmimit mesatar të biletës për linjat ndërqytetëse apo rrethqytetase të shërbimit të transportit, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, dhe të indeksimit të çmimeve të shërbimit të transportit, të botuara çdo vit nga INSTAT-i, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p> <p>Sipas detyrimit ligjor të shprehur në pikën 4, shpenzimet për rimbursimin e çmimit të biletës së transportit për mësuesit i referohen përveç elementëve të tjerë të përcaktuar në këtë VKM, <b>çmimit mesatar të biletës për linjat ndërqytetëse apo rrethqytetase të shërbimit të transportit, të miratuar me VKM nr. 146, datë 26.2.1998 i ndryshuar.</b></p> <p>Referuar Aneksit 1 “Tabela e kilometrave dhe çmimi i biletave për linjat rrethqytetase të Bashkisë Librazhd “(sektori i taksave) miratuar nga Bashkia Librazhd, distanca Librazhd-Orenjë në km është përcaktuar 24, ndërsa çmimi i biletës në lek është përcaktuar 200 lekë, ndërkohë që në VKM Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime në Aneksin 1, Pasqyra 1, “Çmimet e biletave të transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” ka përcaktuar distancat dhe çmimet referuese. Akti i për çmimin e biletave dhe distancat i shprehur në km i nxjerrë nga Bashkia Librazhd dhe Aneksi 1, Pasqyra 1 VKM Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime janë akte të planifikuara dhe sjellin si pasojë, referime të ndryshme çmimi për distanca të njëjta duke krijuar standarde të ndryshme për çmimin e biletës.</p>
<b>Kriteri</b>	-VKM Nr. 682, datë 29.07.2015, e ndryshuar, pika 2 dhe 4.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Mos përputhje në çmimin e biletës së transportit ndërqytetës në Aneksin 1, Pasqyra 1, “Çmimet e biletave të transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” të VKM-së Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime dhe Aneksit 1 “Tabela e kilometrave dhe çmimi i biletave për linjat rrethqytetase të Bashkisë Librazhd “(sektori i taksave) miratuar nga Bashkia Librazhd.
<b>Shkaku</b>	Mos unifikimi i VKM Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime me aktin e nxjerrë nga Bashkia Librazhd për kilometrat dhe çmimin e biletave për linjat rrethqytetase.
<b>Rëndësia</b>	E mesme
<b>Rekomandimi</b>	Të merren masa nga titullari i MAS-it që të propozojë përmirësime ligjore në VKM Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime, Aneksi 1, Pasqyra 1, “Çmimet e biletave të transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” duke bashkëpunuar në këtë drejtim me organet e vetëqeverisjes vendore për unifikimin e distancave në km, shprehur për qytet dhe fshat të RSH si dhe çmimit të miratuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas distancave, me qëllim që Aneksi 1, Pasqyra

1, të jetë gjithëpërfshirës në hartën e transportit ndërqytetës për arsimtarët.

### **Konkluzion:**

Në lidhje me mos rimbursimin e plotë të çmimit të biletës së transportit të mësuesve që udhëtojnë në linjën Librazhd-Gorenjë dhe anasjelltas rezultoi se:

☞ Mungesa e raportimit nga ZVAP Librazhd pranë MAS-it sipas kërkesave të VKM Nr. 682, datë 29.07.2015, pika 5/1 e ndryshuar.

☞ Mos përputhje në çmimin e biletës së transportit ndërqytetës në Aneksin 1, Pasqyra 1, “Çmimet e biletave të transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” të VKM-së Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime dhe Aneksit 1 “Tabela e kilometrave dhe çmimi i biletave për linjat rrethqytetase të Bashkisë Librazhd “(sektori i taksave) miratuar nga Bashkia Librazhd.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është përcjellë (jashtë afatit 7 ditor të parashikuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit) observacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Tiranë përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm znj. R.A, me shkresë Nr. 2041/1, datë 14.12.2022, protokolluar në KLSH me Nr. 895/5, datë 22.12.2022, “Kthim përgjigje për Aktverifikimet Nr.1, datë 18.11.2022 dhe nr.2, datë 25.11.2022”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**1.Pretendimet e subjektit:** “.....Për Aktverifikimin nr.1 datë 18.11.2022 sipas informacionit të marrë në ZVAP Librazhd rezulton se pagesat për rimbursimin e çmimit të biletës janë bërë në përputhje me përcaktimet e pikës 4 të Vendimit nr. 682, datë 29.7.2015.....”.

2.”...Në lidhje me përcaktimet e pikës 5/1.... ZVAP Librazhd deklaroi se e ka dërguar këtë informacion në DRAP Korçë me shkresat... (bashkëlidhur shkresat...)”.

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** 1.Lidhur me këtë pretendim, grupi i auditimit sqaron se, konstatimi KLSH, ka të bëjë konkretisht me mos përputhjen që ekziston mes çmimit të biletës së transportit ndërqytetës në Aneksin 1, Pasqyra 1, “Çmimet e biletave të transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” të VKM-së Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime dhe Aneksit 1 “Tabela e kilometrave dhe çmimi i biletave për linjat rrethqytetase të Bashkisë Librazhd “(sektori i taksave) miratuar nga Bashkia Librazhd. Në këtë aspekt kërkohet të bëhet rregullim ligjor. Pretendimet **merren në konsideratë** në lidhje me procedurën e ndjekur nga ZVAP Librazhd, por qëndrimi i KLSH i referohet rekomandimit për përmirësim ligjor.

2. Lidhur me këtë pretendim, grupi i auditimit pasi shqyrtoi dhe shkresat bashkëlidhur sqaron se, sipas kërkesave të VKM Nr. 682, datë 29.7.2015,e ndryshuar pika 5/1 detyrimi ligjor është raportimi çdo 3 muaj në MAS jo vetëm në DRAP Korçë. Pretendimi **nuk merret në konsideratë**.

-Në zbatim të pikës të II/2 të Programit të Auditimit “Çështje të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit” në lidhje me ankesën datë 07.10.2022 depozituar në KLSH me nr.919 prot., datë 07.10.2022 mbi vlerësimin për vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar/Shkolla e mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastër, profili histori-geografi, u krye verifikimi në ambientet e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Gjirokastër dhe Shkollës së mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastër.

Objekti i verifikimit:

-Ankesa datë 07.10.2022 e depozituar në KLSH me nr.919 prot., datë 07.10.2022 nga znj. E.Ç.



Nga verifikimi rezultoi:

-Në MAS, znj.E.Ç ka adresuar ankesë protokolluar në MAS nr. 5537 prot., datë 29.08.2022 në lidhje me pretendimet që ka mbi vlerësimin përfundimtar të dalë nga konkurrimi i kryer për vend të lirë pune në Shkollën e mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastrë.

-Në lidhje me këtë ankesë, MAS-i me shkresën nr.5537/1, datë 01.09.2022 i dërgon “*për ndjekje dhe kompetencë*” Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Tiranë (DPAP) ku kërkon shqyrtimin e ankesës së ardhur në ministri si dhe të informohet zyrtarisht brenda afatit të përcaktuar në VKM Nr.867, datë 10.12.2014 “*Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore*”.

-DPAP i kthen përgjigje MAS-it dhe për dijeni Drejtorisë së shkollës së mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastrë, për shqyrtimin e ankesës, me anë të shkresës nr.1756/2 prot., datë 07.09.2022 ku i bën me dije se:

-Bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.14 datë 27.5.2021 “*Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit*” neni 106, kreu XXI, bëhen sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin dhe për këtë rast sipas udhëzimit të MAS nr.12, datë 10.06.2021 “*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë” i ndryshuar.*

-Referuar përcaktimeve të pikës 11, kreu 7 të këtij udhëzimi, vlerësimi i dosjeve për të gjithë mësuesit në profilin që ngelen pa ngarkesë mësimore kryhet sipas shtojcës 2.1 të udhëzimit të sipërcituar.

-Për vlerësimin me pikë të vjetërsisë në punë, mësuesit duhet të vlerësohen vetëm për përvojën në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues të institucionit arsimor.

-Për sa sipër, KVD (*Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve*) në shkollën e mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastrë, duhet të kryej vlerësimin e dosjeve për dy mësuesit e profilin histori-geografi sipas përcaktimeve të shtojcës 2.1 dhe për mësuesit e renditur me më pak pikë në këtë proces duhet të vijojnë procedurat konform përcaktimeve të pikës 5,7,8,9,12 dhe 13 të Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 i ndryshuar.

-Në lidhje me vlerësimin që i bën DPAP ankesës, nga Shkolla mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastrë, është bërë kthimi i përgjigjes me shkresën nr.237 datë 12.09.2022, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, ku bën me dije se:

“...komisioni (KVD), pasi shqyrtoi dokumentacionin e njehsuar me origjinalin të dy dosjeve të mësuesve respektivë, realizoi pikëzimin dhe e bëri transparent me të dyja konkurrentët”.

### **Konkluzion:**

Në lidhje me procedurën e ndjekur nga Shkollën e mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastrë, mbi ankesën e bërë në MAS për vlerësimin për vend të lirë pune, rezultoi se:

☞ Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar informon MAS-in dhe për dijeni Drejtorinë e shkollës së mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastrë, së cilës i kërkon, që KVD (*Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve*) në shkollën e mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastrë, duhet të kryej vlerësimin e dosjeve për dy mësuesit e profilin histori-geografi sipas përcaktimeve të shtojcës 2.1 dhe për mësuesit e renditur me më pak pikë në këtë proces duhet të vijojnë procedurat konform përcaktimeve të pikës 5,7,8,9,12 dhe 13 të Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 i ndryshuar.

☞ Shkolla mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastrë me shkresën nr.237 datë 12.09.2022, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe për dijeni Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimin, i kthen përgjigje ankesës duke bërë me dije vlerësimin dhe transparencën për dy mësueset.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është përcjellë (*jashtë afatit 7 ditor të parashikuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit*) observacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Tiranë përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm znj. R.A, me shkresë Nr. 2041/1, datë 14.12.2022, protokolluar në KLSH me Nr. 895/5, datë 22.12.2022, “*Kthim përgjigje për Aktverifikimet Nr.1, datë 18.11.2022 dhe nr.2, datë 25.11.2022*”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**1.Pretendimet e subjektit:** “.....Për Aktverifikimin nr.2 datë 25.11.2022 DPAP deklaroi se ka kthyer përgjigje për ankesat e dërguara nga znj. E.Ç. Nga DPAP i është kërkuar Komisionit të Vlerësimit të dosjeve në institucionin e arsimit profesional “Thoma Papapano Gjirokastër” ti përmbahet përcaktimeve të shtojcës 2.1 ...Theksojmë se shkollat e arsimit profesional janë në varësi të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimit, e cila është në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Menaxhimi i burimeve njerëzore bëhet në mbështetje të Udhëzimit nr. 14, datë 27.5.2021, neni 106 përcakton se..... por institucionet në varësi të DPAP-së nuk mund të monitorojnë procedurat e brendshme të institucioneve arsimore profesionale”.

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** 1.Lidhur me këtë pretendim, grupi i auditimit sqaron se, konstatimi KLSH, ka të bëjë me rekomandimin e KLSH që në planifikimin vjetor për 2023, nga auditimi i brendshëm i MAS të bëhet auditim tematik në ZVAP Gjirokastër në lidhje me procedurat e marrjes në punës apo të lëvizjes paralele të personelit të lëndës së kulturës së përgjithshme. Në këtë aspekt pretendimi i DPAP merret në konsideratë, por qëndrimi i KLSH i referohet rekomandimit për planifikimin e auditimeve për 2023 nga MAS në ZVAP Gjirokastër.

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

### A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikave mbi shpërblimin e sportistëve elitë për periudhën 01.01.2021 deri me 30.06.2022 rezultoi se:

- Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar nuk parashikon afate ligjore në të cilën kalon procedura e shpërblimit të sportistëve elitë, duke filluar nga shpallja e rezultateve zyrtare, përgjigja zyrtare për testet antidoping nga organizmat përkatës njohura me ligj deri në finalizimin për dhënie e shpërblimit, si dhe mos parashikimi i të drejtës së ankimit dhe organit që e shqyrton, në rastet kur kërkesa për shpërblim nuk pranohet, nuk merret në shqyrtim apo refuzohet. (*Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 6-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**1.1Rekomandimi:** Të merren masa nga MAS-i për propozimin për përmirësimin e legjislacionit për sportin duke bërë shtesat e nevojshme në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, për vendosjen e afateve ligjore nëpër të cilën kalon procedura e shpërblimit të sportistëve elitë, që nga shpallja e rezultateve zyrtare, përgjigja zyrtare për testet antidoping nga organizmat përkatës të njohur me ligj deri në finalizimin për dhënie e shpërblimit, si dhe parashikimin e të drejtës së ankimit dhe organit që e shqyrton, në rastet kur kërkesa për shpërblim nuk pranohet, nuk merret në shqyrtim apo refuzohet.

#### Në vijimësi

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikës së shpërblimit të sportistit M.M rezultoi se:

- Shkresa nr.46 prot., datë 30.03.2022 e Federatës nuk figuron e administruar në protokollin e MAS-it për pasojë nuk është kthyer përgjigje kësaj kërkesë;

-nuk është bërë verifikimi apo dhe të jetë shprehur në arsyetimin e kthimit të përgjigjes (*me shkresën nr. 5639/1 prot., datë 13.10.2022*) se eventit kampionati “IFBB DIAMOND CUP

PORTUGAL & IFBB ELITE PRO WORLD CHAMPIONSHIPS” (ku në kuptimin e përgjithshëm përfshihet në termin “kampionat botëror”) për të cilin kërkohet shpërblimi, referuar rregulloreve ndërkombëtare të këtyre veprimtarive, nuk figuron të jetë i përfshirë si event për të cilin ligji dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021 nuk parashikon shpërblim. (Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 6-15 të Raportit Përfundimtar Auditimit)

**2.1Rekomandimi:** Të merren masa nga MAS për propozimin për përmirësim të legjislacionit për sportet duke kërkuar shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, konkretisht të nenit 27, pika 1, germa “c”, me qëllim përcaktimin e saktë të të gjithë eventeve të listuara për të cilat ligji njih të drejtën e shpërblimit.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i bërë në ZVAP Librazhd në përgjigje të ankesës së ardhur në KLSH si dhe në MAS mbi rimbursimin e plotë të çmimit të biletës së transportit të mësuesve që udhëtojnë në linjën Librazhd-Gorenjë dhe anasjelltas, rezultoi se: Referuar Aneksit 1 “Tabela e kilometrave dhe çmimi i biletave për linjat rrethqytetase të Bashkisë Librazhd” (sektori i taksave) miratuar nga Bashkia Librazhd, distanca Librazhd-Orenjë në km është përcaktuar 24, ndërsa çmimi i biletës në lek është përcaktuar 200 lekë, ndërkohë që në VKM Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime në Aneksin 1, Pasqyra 1, “Çmimet e bileta vetë transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” ka përcaktuar distancat dhe çmimet referuese. Akti i nxjerrë nga Bashkia Librazhd për çmimin e biletave dhe distancat i shprehur në km si dhe Aneksi 1, Pasqyra 1 e VKM-së Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime janë akte të pa unifikuara dhe sjellin si pasojë, referime të ndryshme çmimi për distanca të njëjta duke krijuar standarde të ndryshme për çmimin e biletës. (Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.2, faqe 15-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**3.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga titullari i MAS-it që të propozojë përmirësim në VKM Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime, Aneksi 1, Pasqyra 1 “Çmimet e biletave të transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” duke bashkëpunuar në këtë drejtim me organet e vetëqeverisjes vendore për unifikimin e distancave në km, shprehur për qytet dhe fshat të RSH si dhe çmimit të miratuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas distancave, me qëllim që Aneksi 1, Pasqyra 1, të jetë gjithëpërfshirës në hartën e transportit ndërqytetës për arsimtarët.

**Menjëherë**

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikave mbi shpërblimin e sportistëve elitë për periudhën 01.01.2021 deri me 30.06.2022 rezultoi se:

-rregullorja e brendshme nuk është e përditësuar me përshkrimet e proceseve të punës për drejtoritë përkatëse në aspektin e përgjithshëm dhe atë specifik, për pasojë nuk është përfshirë si përshkrim pune dhe trajtimi i kërkesave për shpërblim të sportistëve elitë e cila formalisht bëhet nga një grup pune në përbërje të të cilit nuk ka specialist të fushës,  
-mungon një bazë të dhënash/data bazë tip e miratuar, e cila të japë informacion të analitik për procedurën e shpërblimit të sportistëve elitë, me qëllim transparencën dhe auditimin e tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 6-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**1.1Rekomandimi:** Të merren masa nga titullari i institucionit/MAS, për përditësimin e rregullores së brendshme të funksionimit me ndryshimet e reja strukturore duke përcaktuar qartë përshkrimin e proceseve të punës për drejtoritë përkatëse, specifikisht ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës për shqyrtimin dhe vlerësimin e shpërblimit për sportistët elitë ku në përbërje të jetë specialisti i fushës, si dhe miratimin si pjesë integrale të rregullores së data bazës së të dhënave për shpërblimin e sportistëve elitë.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikës së shpërblimit të sportistit M.M rezultoi se:  
- Shkresa nr.46 prot., datë 30.03.2022 e Federatës nuk figuron e administruar në protokollin e MAS-it për pasojë nuk është kthyer përgjigje kësaj kërkesë;

-nuk është bërë verifikimi apo dhe të jetë shprehur në arsyetimin e kthimit të përgjigjes (me shkresën nr. 5639/1 prot., datë 13.10.2022) se event i kampionati “IFBB DIAMOND CUP PORTUGAL & IFBB ELITE PRO WORLD CHAMPIONSHIPS” (ku në kuptimin e përgjithshëm përfshihet në termin “kampionat botëror”) për të cilin kërkohet shpërblimi, referuar rregulloreve ndërkombëtare të këtyre veprimtarive, nuk figuron të jetë i përfshirë si event për të cilin ligji dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021 nuk parashikon shpërblim. (Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 6-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**2.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga MAS për shqyrtimin e kërkesës së Federatës nr.46 prot., datë 30.03.2022 për shpërblimin e sportistit M.M në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar.

#### Menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në 4 praktika për shpërblimin e sportistëve elitar, ka parregullsi dhe mungesa në administrimin e dokumentacionit, trajtuar rast pas rasti duke ju referuar praktikave për sportistët B.C, B.C, E.Q dhe A.Q konkretisht:

-mungesa e rezultatit/përgjigjes përfundimtare të testeve antidoping jo në përputhje me kërkesat e VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pika 13. (Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 6-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**3.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Drejtoria e Politikave të Sportit/Spektori i Zhvillimit të Sportit Elitar për plotësimin e dokumentacionit të shpërblimit për sportistët B.C, B.C, E.Q dhe A.Q e në vijimësi me praktikën e tjera dhe inventarizimin e dosjeve.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikave mbi shpërblimin e sportistëve elitar për periudhën 01.01.2021 deri me 30.06.2022 rezultoi mungesa e inventarizimit të dosjeve me dokumentacionin përkatës të protokolluar sipas legjislacionit “Për arkivat”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 6-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**4.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Nëpunësi Zbatues për procesin e inventarizimit të praktikave/dosjeve për shpërblimin e sportistëve elitar.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i bërë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Gjirokastrë, si rezultat i ankesës së ardhur në KLSH, por dhe në MAS, në lidhje me vlerësimin për vend të lirë pune, në Shkollën e mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastrë të znj.E.Ç rezultoi se: Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar informon MAS-in dhe për dijeni Drejtorinë e shkollës së mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastrë, së cilës i kërkon, që KVD (Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve) të kësaj shkolle, duhet të kryej vlerësimin e dosjeve për dy mësuesit e profilit histori-geografi sipas përcaktimeve të shtojcës 2.1 dhe për mësuesit e renditur me më pak pikë në këtë proces duhet të vijojnë procedurat konform përcaktimeve të pikës 5,7,8,9,12 dhe 13 të Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 i ndryshuar. Në përgjigje të kësaj, shkolla mesme profesionale “Thoma Papajano” Gjirokastrë me shkresën nr.237 datë 12.09.2022, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe për dijeni Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit, i kthen përgjigje duke bërë me dije vlerësimin dhe transparencën për dy mësueset. Në këto kushte, për të gjykuar nëse është ndjekur kjo procedurë konform kriterëve të përcaktuara, duhet të vlerësohet nga auditimi i brendshëm i MAS-it. (Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.2, faqe 19-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**5.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga MAS që Drejtoria e Auditit të Brendshëm të përfshijë në planin e auditimit vjetor 2023 dhe auditimin në ZVAP Gjirokastrë, me tematikë procedurat e ndjekura nga shkollat në rastet e konkurrimit për vend të lirë pune. (Referuar ankimit të znj. E.Ç).

#### Deri në qershor 2023

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## KONTROLLI I LARTE I SHTETIT